



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0995
Data e Vendimit: 13.03.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “Crystal Clear” Sh.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së” me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Gjakovës”, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 13.03.2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar, ankesa e “Crystal Clear” Sh.P.K me nr. të protokollit 2023/0995 , e datës 11/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së”, me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Gjakovës”.

I lejohet, autoritetit kontraktues – “Komuna e Gjakovës” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së”, me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 11.12.2023, ka pranuar ankesën me Nr. Protokollit 995/23 nga OE “Crystal Clear” Sh.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së” me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, inicuar “Komuna e Gjakovës” në cilësinë e Autoriteti

Kontraktues.

Me datë 09.11.2023, “Komuna e Gjakovës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë.

Me datë 29.11.2023 OE “Crystal Clear” Sh.P.K kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 30.11.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa bazuar.

Me datë 22.11.2023 është bërë publikimi i Dosjes së Tenderit

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me datë 30.11.2023 ka qenë e paraparë hapsja e ofertës. Fillimisht Kërkesa për Rishqyrtim ka pasur nga Operatorë Ekonomik tjetër me datë 22.11.2023, me çrast AK e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, kurse me datë 24.11.2023 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim. Me datë 27.11.2023, AK e ka shtyer afatin për ofertim deri me datë 30.11.2023 por, nuk ka bërë asnjë ndryshim tjetër në kërkesat e dosjes së tenderit. OE ankues ka bërë ankesë në DT në të cilën AK e ka publikuar dhe afati për ankesa për rishqyrtim ka qenë me datë 24.11.2023. Sipas AK-së ka qenë e obliguar të shtyej vetëm afatin për ofertim sepse aktiviteti, ka qenë i pezulluar sipas kërkesës paraprake. Andaj, paneli vlerëson se ky ankues ka pas për qëllim vetëm prolongimin e aktivitetit të prokurimit kurse sipas përmbajtjes së ankesës nuk ka asnjë pretnedim ankimor përveq civateve të neneve të LPP-së.

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së” me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, inicuar nga “Komuna e Gjakovës”, njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 09.11.2023, afati i fundit për praninë të tenderëve ishte data 30.11.2023. Ndërsa me datë 29.11.2023 OE “Crystal Clear” Sh.P.K kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 30.11.2023 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa bazuar.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtror kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkëlja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*

Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).*

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 11/12/2023 nga OE “Crystal Clear” Sh.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së” me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1 inicuar nga “Komuna e

Gjakovës” , hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës ne OSHP konform nenit 111 të LPP-së.

Autoritetit kontraktues – “Komuna e Gjakovës” mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së” me numër të prokurimit 632-23-11804-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë, OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen *vetëm në kriteret e nevojshme* për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues **nuk duhet** që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60,65,69,70 të LPP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - CRYSTAL CLEAR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: